



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 44

Prishtinë, më 13.1.2012, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri.

Munguan : Etem Arifi, Daut Haradinaj, Rasim Demiri.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Deputeti Hydajet Hyseni, zyrtar nga MMPH dhe ministri Dardan Gashi, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), ICO, Ambasada Amerikane, media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 12.1.2012,**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për Prizrenin,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.1.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12.1.2012 me përmirësimet nga mbledhja e sotme.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Prizrenin

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit dhe falënderoj për punën e palodhshme të komisionit dhe bashkëpunëtorëve gjatë këtyre ditëve.

Para se të shqyrtohet projektligji i radhës, Kryetari ftoi Komisionin për votimin e Amendamenteve të propozuara për projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe, ndaj Komisioni nxori:

P Ë R F U N D I M

MIRATOHET raporti me rekomandime i komisionit, rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe me amendamentet si vijon :

Amendamenti 1

Neni 1, riformulohet :

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohor të fshatit Hoça e Madhe si pronë e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si zonë e veçantë e mbrojtur.

Amendamenti 2

Neni 2, riformulohet si në vijim: “Me këtë ligj përcaktohet e drejta e administrimit të kufizuar e Fshatit Hoçë e Madhe për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe fetare si dhe të planifikimit rural në pajtim me ligjet në fuqi”.

Nuk përkrahet Amendamenti 2 nga **Hydajet Hyseni**.

Amendamenti 3

Në nenin 3, pika 1. 10, fjala “**Komitet**“ të zëvendësohet me fjalën „**Këshill**“, si dhe në tërë tekstin e projektligjit, fjala “**Komitet**“ zëvendësohet me fjalën “**Këshill**“.

Me mbështetje të Deputetit **Hydajet Hyseni** (ashtu si është në versionin anglisht).

Amendamenti 4

Neni 4, paragrafi 2, riformulohet si në vijim : “**Këshilli themelohet nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit**”.

Neni 4, paragrafi 3 riformulohet si në vijim :

3. Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve:

3.1. katër (4) anëtarë zgjedhën nga Kuvendi i Komunës dhe

3.2. tre (3) anëtarë zgjedhën drejtpërdrejtë nga qytetarët e fshatit të Hoçës së Madhe.

Nuk përkrahet Amendamenti 4, 5 dhe 6 i deputetit **Hydajet Hyseni**.

Nuk përkrahet Amendamenti 1 i Qeverisë.

Amendamenti 5

Përkrahet Amendamenti 7 nga deputeti **Hydajet Hyseni** me të cilin tek Neni 5.1 fshihen fjalët “...zbatojnë ose integrojnë...”

Neni 5, paragrafi 5 riformulohet si në vijim :

5. Ne rast të mosmarrëveshjeve në mes të Këshillit dhe autoriteteve komunale, palët do të referojnë çështjen në KZM, Këshillit për Trashëgimi Kulturor të Kosovës, Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për shqyrtim.

Amendamenti 6

Përkrahet Amendamenti 8 nga **Hydajet Hyseni** për shtesën në fund të tekstit tek Neni 5 pika 5.2 dhe për shtesën në fund të tekstit tek Neni 6 pika 6.1.1 si vijon :

“si dhe me Konventën e UNESCO-së për trashëgiminë kulturore dhe natyrore, deklaratën universale të UNESCO-së për diversitetin kulturor dhe në Traktatin e Mastrohtit”.

Nuk përkrahet Amendamenti 9 nga deputeti **Hydajet Hyseni** rreth pikës 5.5.

Nuk përkrahet Amendamenti 2 i **Qeverisë** për ta shtuar paragrafin 6 në Nenin 5.

Neni 6, paragrafi 1, rreshti i tretë, fshihen fjalët “autoritet të kufizuar në”.

Nuk përkrahet Amendamenti 3 i **Qeverisë** për të shtuar dy nënparagraf në fund të Nenit 7.

Amendamenti 7

Neni 8, në titull fjala “karakterit” bëhet “karakteristikave”, **paragrafi 1** riformulohet:

“Me qëllim të ruajtjes së strukturës dhe karakteristikës së veçantë të fshatit me planin e konservimit, ndalohen përkatësisht kufizohen këto aktivitete :”.

Nuk përkrahet Amendamenti 10 nga deputeti **Hydajet Hyseni** për të bartur disa paragrafë nga Neni 8 tek Nenin 6 dhe 7.

Amendamenti 8

Përkrahet Amendamenti 4 i **Qeverisë** si vijon :

Neni 9, zëvendësohet si në vijim :

Neni 9

Procedura e shqyrtimit të kërkesave për leje në kuadër të ZVM

1. Përveç kushteve për dhënie të lejeve që kërkojnë sipas legjislacionit në fuqi, procedura për dhënien e kërkesave për leje në ZVM përfshin edhe ndërmarrjen e këtyre veprimeve:

1.1. Komuna i dorëzon Këshillit të gjitha kërkesat e shqyrtuara për leje brenda ZVM-së me rekomandimet e saj profesionale;

1.2. Këshilli i shqyrton të gjitha rekomandimet për leje në përputhje me ligjet në fuqi;

1.3. Këshilli mund të mos pajtohet me një rekomandim për leje vetëm nëse konsideron se ajo nuk është në përputhje me planet hapësinore dhe urbane dhe ligjet në fuqi;

- 1.4. Këshilli i shqyrton rekomandimin për leje, dhe e informon Komunën për pëlqimin ose refuzimin nga ana e tij brenda 15 ditësh;
- 1.5 Komuna i shqyrton rekomandimet e Këshillit në të gjitha rastet;
- 1.6. Nëse Këshilli nuk përgjigjet brenda 15 ditësh, konsiderohet se rekomandimi i Komunës ka marrë pëlqimin nga Këshilli.

Ky amendament është përmirësuar nga MMPH (në praninë e ministrit Dardan Gashi) gjatë takimit sa i përket fjalës Komitet e cila u zëvendësua me fjalën Këshill.

Amendamenti 9

Neni 10, paragrafi 1, rreshti i parë, fshihen fjalët “me vota”.

Paragrafi 2, në fund fshihen fjalët “me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe me”.

Ky amendament i komisionit përkrahet nga Qeveria.

Kryetari pasi që falënderoi, vazhdoi me konstatimin se lehtësim gjatë shqyrtimit të projektligjit për Prizrenin do të jetë fakti se Prizreni ka institutin për trashëgimi dhe planin e konservimit, ja dha fjalën fillimisht **Hydajet Hysenit** i cili tha se këto dy projektligje tanimë janë të proceduara në Kuvendin e Kosovës por një gjë duhet të dihet se Pakoja e Ahtisarit nuk potencon faktin se duhet të ekzistojnë dy ligje të veçanta për këto dy zona por vetëm një.

Ministri **Dardan Gashi** potencoi faktin se pas leximit të parë të këtij projektligji, MMPH ka vepruar konform kërkesave nga Kuvendi i Komunës Prizren dhe shoqatave duke propozuar vërejtjet konkrete të cilat do të shqyrtohen në vazhdim të punës së këtij komisioni.

Liburn Aliu konstatoi se ky projektligj bien në kundërshtim me Kushtetutën rreth laicitetit dhe neutralitetit ndaj besimeve tjera, parashtrroi pyetjen përfaqësueses së ICO rreth “Mahallës së Marrashit” a është objekt apo zonë kulturore fetare serbe, dhe si. Ai gjithashtu pyeti të pranishmit (me fokus MMPH-në) a janë të gatshëm për ndryshime të përbashkëta dhe të harmonizuar me komisionin në këtë projektligj, ngase komisioni ka disa mospajtime rreth projektligjit të propozuar. **Ministri Dardan Gashi** tha se nuk ka asnjë arsye për mosbashkëpunim, përkundrazi është insistimi i MMPH të arrijnë pajtimin me komisionin për këtë projekt, ndërsa **përfaqësuesja e ICO dhe Gjejlane Hoxha** konstatuan se nuk përfaqësojnë adresën e duhur për përgjigje rreth pyetjes së z. Aliu ngase ICO vetëm zbaton Pakon e Ahtisarit. **Hydajet Hyseni** potencoi se Ligji për Prizrenin kërkohet por vetëm për disa çështje të veçanta, zona të mbrojtura, ndërtesa të reja (zgjerimet tej mase) etj por assesi për tërë Prizrenin, ndaj edhe ka propozuar Amendamentin 1 për ndryshimin e emrit të ligjit (Ligji për aktivitetet e kufizuara brenda zonës së veçantë të qendrës historike të Prizrenit-QHP).

Në vazhdim komisioni shqyrtoi dhe nxori rekomandimet si vijon :

Amendamenti 1 (Deputeti Hydajet Hyseni)

Titulli ekzistues e Projektligjit, riformulohet në :

Ligji për aktivitetet e kufizuara brenda Zonës së Vecantë të Qendrës Historike të Prizrenit.
Ky ndryshim inkorporohet në gjithë materien e Ligjit.

Vjosa Vela arsyetoi mosmiratimin e amendamentit ngase një model i tillë është edhe në Shqipëri (Zona e qytetit Berat). Edhe **Liburn Aliu** dhe **Salih Morina** nuk përkrahën amendamentin. **Hydajet Hyseni** konstatoi se ky nguti i miratimit të këtij ligji vjen nga ndërkombëtarët, përndryshe kemi të bëjmë me mashtrimin e qytetarit të Prizrenit, ngase ky ligj e ka emrin e madhë por punët që i rregullon janë të veçanta.

Gjejlane Hoxha gjithashtu shfaqti brengosjen ngase duhet të definohet a kemi të bëjmë me PROTECT AREA apo PROTECT ZONE (cituar nga anglishtja). Ajo tha se në grupet punuese gjatë draftimit të projektligjit përfaqësuesit vendor kanë qenë të mrekullushëm, mirëpo fatkeqësisht më vonë “tjetër kush ka pre shiritin” dhe janë bërë gabime të tmerrshme. Megjithatë, ajo apeloj që të rregullohen gabimet brenda në ligj, titulli mund të mbetet si është.

Liburn Aliu bëri apel të shtyhet shqyrtimi i këtij projekti për një muaj, madje të angazhohet një ekspert ndërkombëtarë.

Amendamenti nuk u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 2 (Komisioni)

Neni 1, riformulohet :

Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.

Nuk përkrahet Amendamenti 2 i deputetit **Hydajet Hyseni**.

Amendamenti 3 (Komisioni)

Neni 2 dhe **Neni 3** riformulohen dhe bashkohen në një Nen si vijon (bëhet rirenditja i Neneve të radhës) :

Neni 2

Fushëveprimi dhe parimet e përgjithshme

1. Administrimi i Qendrës historike të Prizrenit të mbrojtur zhvillohet duke u bazuar në parimet e përgjithshme vijuese :

1.1 mbrojtja, ruajtja, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e karakteristikave tradicionale historike urbane të Qendrës historike të Prizrenit të mbrojtur bëhet sipas parametrave të elaboruar në nenet 5,6,7 dhe 8 në planin e konservimit, pjesë integrale e këtij ligji, Shtojca 1;

1.2 integrimi i Qendrës historike të Prizrenit të mbrojtur në të gjitha nivelet e planeve hapsinore e urbanistike zhvillimore të vendit;

1.3 rehabilitimi, restaurimi, adaptimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave, monumenteve dhe mjediseve të tyre rrethuese në përputhje me standarde profesionale për konservim dhe restaurim;

1.4 elaborimi i politikës dhe planit të menaxhimit të konservimit, me përcaktim të normave, detyrave dhe mënyrave të bashkëpunimit me autoritetet e trashëgimisë kulturore, autoritetet e planifikimit hapësinor dhe zhvillimor të vendit, autoritetet e qeverisjes komunale të Prizrenit dhe popullata;

1.5 përcaktimi i të drejtave dhe obligimeve të poseduesve të pronave të trashëgimisë kulturore në mbrojtje;

1.6 pjesmarrja në një proces transparent vendim/marrjeje të palëve të ndryshme të interesit;

1.7 sigurimi i fondeve sistematike për restaurim dhe mirëmbajtje të Qendrës historike të Prizrenit duke përfshirë të gjitha elementet përbërëse të saj, përmes sigurimit të lehtësirave fiskale duke bërë stimulimin e zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit të kushteve të jetesës.

2. Konservimi dhe mbrojtja e Qendrës Historike të Prizrenit bëhet në pajtim me parimet dhe standardet ndërkombëtare në pajtim me Ligjin e trashëgimisë kulturore, Ligjin për

Planifikim Hapësinor dhe dokumente ndërkombëtare të UNESCO-s për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Amendamenti 4 (Amendament i deputetit **Hydajet Hyseni** i përkrahur nga Komisioni)

Neni 4, në paragrafin 1.1 shprehja “të themeluar me këtë ligj” zëvendësohet me “**bazuar me këtë ligj**”, ndërsa në tekstin e mëtejshëm të nenit, në çdo pikë hiqet fjala “**nënkupton**” e cila zëvendësohet me shenjën (:) dy pika.

Amendamenti 5 (Amendament i përbashkët i Komisionit, deputetit Hydajet Hyseni dhe Qeverisë)

Neni 4, paragrafi 1.7, te, në Nenin 16 dhe gjithkund në ligj, emertimi “**Komitet**” zëvendësohet me “**Këshill**”.

Komisioni përfundoi punën me 4 amendamente (një i pa përkrahur) dhe do të vazhdoi mbledhjen të hënën më 16 janar në orën 10,00 me shqzrtimin e Nenit 5, kur do të ftohet edhe drejtoresha e departamentit të kulturës në Ministrinë e kulturës Vjollca Aliu.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,50.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani